



VENDIM

Nr. 10, Datë 19.01.2017

**MBI
MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“A-V COMPASS POWER” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit Nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma ”e”; 5, gërma ”e”; 8 dhe 10 pikat 1, 2, 3 të ”Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ”Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për aplikimin për licensim të shoqërisë ”A-V COMPASS POWER” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë ”A-V COMPASS POWER” sh.p.k, nuk plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në ”Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ”a”, ”b”, ”c”, është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ”a”, ”b”, ”c”, ”f”, ”g”) është plotësuar në mënyrë korrekte; (Neni 9 pika 2, gërmat ”d” dhe ”e”), nuk janë plotësuar.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat ”a”, ”b”, ”c”, ”d”) nuk është plotësuar;
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës, (neni 9, pika 4/8 gërmat ”a”, ”b”, ”c” dhe ”d”) nuk është plotësuar;

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “A-V COMPASS POWER” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI